



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:067382

Datë: 27.05.2019

Numri i dokumentit: 00331095

P.nr.1857/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN -DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni– sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit V.D nga fshati, Komuna e, me nr.personal i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.2733-6/18 të datës 14.11.2018, për shkak të veprës penale, vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-së, në shqyrtimin e dytë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit-Milot Krasniqi dhe të akuzuarit, me datë 24.05.2019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V.D, nga i ati A. dhe e ëma L., e vajzërisë P., i lindur me në, jeton në fshatin, Komuna e, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 14.10.2018, rreth orës 18:30 minuta, në Prizren në rrugën “....”, saktësisht në lokalin e të dëmtuarit A.L, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, shfrytëzon momentin e pakujdesisë, ia merr kuletën dhe pazarin ditor të lokalit “.....”, po ashtu edhe dokumentet personale të punëtores së tij dhe largohet nga vendi i ngjarjes, me ç’rast të dëmtuarit i shkakton dëm material në vlerë prej 280 € (dyqindë e tetëdhjetë) euro.

-Këso dore kryen veprën penale, vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit të lartëcekur dhe neneve 4, 6, 7,17, 41, 42, 46, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73 nenin 275 par.1 të KPRK-së dhe nenin 365 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej **300 € (treqindë euro)**, të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur 20 € të gjobës në një ditë burgim, përkatsisht 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim.

DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **4 (katër) muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I akuzuari V.D, obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 euro dhe për programin e viktimave të krimit shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 69 par.2 të KP-së, të akuzuarit i konfiskohet thika me mbishkrimin Famipa, tehu rreth 15 cm.

I dëmtuari A. L nga, rr.”....”, nr....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokurori i Shtetit në Prizren-Prokuroria Themelore-Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/IL.nr.2733-6/18 të datës 14.11.2018, kundër të akuzuarit V.D nga fshati, Komuna e për shkak të veprës penale, vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin e dytë, në të cilën i akuzuari V.D, ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.

Gjykata në shqyrtimin e dytë nga pranimi i fajësisë dhe provat materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari V.D, ditën kritike, me datë 14.10.2018, rreth orës 18:30 minuta, në në rrugën “....”, saktësisht në lokalit të dëmtuarit A. L., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, shfrytëzon momentin e pakujdesisë, ia merr kuletën dhe pazarin ditor të lokalit “....”, po ashtu edhe dokumentet personale të punëtores së tij dhe

largohet nga vendi i ngjarjes, me ç'rast të dëmtuarit i shkakton dëm material në vlerë prej 280 € (dyqindë e tetëdhjetë) euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari V.D, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare ka gjetur se nuk ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se i akuzuari prej fillimit të hetimeve e gjerë në këtë shqyrtim ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KP-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana tejet lehtësuese ka konsideruar, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë veprime kundërligjore, bashkëpunimin e ti me gjykatën duke ju përgjigjur çdo ftese të saj si dhe moshën e tij të re. Kështu që kjo gjykatë ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me peshën e veprës penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe sipas bindjes së gjykatës dënimi i tillë do të ndikoj mjaftueshëm te i akuzuari dhe në rrethinën ku ai jeton që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e tilla inkriminuese.

Vendimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 parag.3 pika 1 të Ligjit nr.05/L-036.

Vendimi mbi konfiskimin është marr konform nenit 69 par.2 të KP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2018:067382, 24.05.2019**

Procesmbajtësja
Luljeta Luboteni

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Sadije Selmani

UDHËZIM JURIDIKË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.